



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.5

29 janar

2009

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr.6023 datë 22.1.2009	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 69
Dekret nr.6024 datë 22.1.2009	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 69
Dekret nr.6030 datë 28.1.2009	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 70
Vendim i KM nr.17, datë 7.1.2009	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.179, datë 22.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e njësive të integritit europian në ministrinë e linjës” 70
Vendim i KM nr.18, datë 7.1.2009	Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve, që do të mbështeten, dhe të masave të përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural 74
Vendim i KM nr.20, datë 14.1.2009	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të administratës gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit 76
Vendim i KM nr.21, datë 14.1.2009	Për miratimin e kuadrit makroekonomik dhe të treguesve fiskalë, për periudhën 2010-2012 78
Vendim i KM nr.52, datë 14.1.2009	Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil (diezel), të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të tregtuar për automjete rrugore e gjeneratorë..... 82
Udhëzim i MF & METE nr.9, datë 29.1.2009	Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.1.2009 “Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil (diezel) të rafinuar nga prodhimi i naftës bruto të nxjerrë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe tregtuar për automjete rrugore dhe gjeneratorë” 83

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare

DEKRET
Nr.6023, datë 22.1.2009

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 14,19 dhe 24 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U rrijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Lulzim Shefqet Xhixha
2. Ilia Nikolla Hanxhara
3. Anastasia Jorgji Hanxhara
4. Andrea Ilia Hanxhara
5. Vangjel Ilia Hanxhara

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6024, datë 22.1.2009

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 9 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Irina Nikollai Dymishi
2. Natalia Alexei Çinari (Şchepu)
3. Valbona Samedin Elmazi (Dervishi)
4. Sarra Madani Dardha (Mrhimimi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6030, datë 28.1.2009

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9, pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij:
Ahmed Nazmi Jonuzi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.17, datë 7.1.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.179, DATË 22.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E NJËSIVE TË INTEGRIMIT EUROPIAN NË MINISTRITË E LINJËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafëve të parë e të dytë, të nenit 4 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Ministrit të Integritimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.179, datë 22.2.2006 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Krijimin e njësive të integritimit europian, si struktura të veçanta, në nivel drejtorie, në përbërje të të gjitha ministrive, me përjashtim të Ministrisë së Integritimit.

Institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit ose të ministrit, krijojnë njësitë e integritimit europian, në përputhje me nevojat e tyre.”.

2. Në fund të pikës 3 shtohen fjalët: “...por jo më pak se tre nëpunës.”.

3. Pas shkronjës “e” të pikës 5 shtohen shkronjat “e” e “f”, me këtë përmbajtje:

“ë) bashkërendimin dhe monitorimin e programimit të ndihmës komunitare, që mund të ofrohet, në kuadër të integritimit europian;

f) mbështetjen teknike të mbledhjeve të grupeve të punës të përhershme, sipas kapitujve të *acquis communautaire*-GPKA;”.

4. Në pikën 6, fjalët “...për këto ministri...” zëvendësohen me “...për institucionet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij vendimi...”.

5. Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

“7. Ngarkohen institucionet e përmendura në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, të cilat nuk i kanë implementuar, brenda strukturës së tyre, këto njësi të integritimit, të paraqesin, për miratim, te Kryeministri, propozimet për ngritjen e këtyre njësive, brenda muajit janar 2009.”.

6. Pika 8 ndryshohet si më poshtë vijon:

“8. Ngarkohen institucionet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij vendimi dhe Ministria e

Integrimit për zbatimin e këtij vendimi.”.

7. Aneksat I e II, që i bashkëlidhen vendimit nr.179, datë 22.2.2006 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen me anekset I e II, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI I

FUSHAT SEKTORIALE QË DO TË KOORDINOJNË RESPEKTIVISHT NGA NJËSITË E INTEGRIMIT EUROPIAN

Institucioni	Fushat
Të gjitha ministratë	Lufta kundër korrupsionit
Ministria e Drejtësisë	-Sistemi gjyqësor; -Përmirësimi i sistemit të burgjeve; -Përmirësimi i funksionimit të sistemit përmbartimor; -Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve; -Sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme; -Kthimi dhe kompensimi i pronave; -Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar; -Njohja reciproke e kualifikimeve për profesionet e lira.
Ministria e Jashtme	-Politika e vizave, politika e jashtme, minoritetet
Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	-Siguria ushqimore; -Shërbimet veterinarë; -Prodhimi bimor; -Agropërpunimi dhe marketingu; -Blegtoaria; -Mbrojtja e bimëve; -Zhvillimi rural; -Reforma e tokës, tregu, administrimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e tokës; -Plehrat kimike/kimikatet-MBUMK (është përgjegjëse për kimikate si pesticide).
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	-Ndihma shtetërore; -Të drejtat e pronësisë industriale; -Marrëveshje të tregtisë së lirë; -Andidumping; -Standardizimi dhe certifikimi; -Akreditimi; -Metrologjia ligjore dhe parapaketimet; -Direktivat e përafrimit teknik (<i>Në Approach</i>) Pajisjet elektrike; Enët me presion; Lodrat; Përputhshmëria elektromagnetike; Makinëritë; Pajisjet e mbrojtjes personale; Pajisje me gaz; Mbi kërkesat për efikasitetin e bojlerëve të rinj që punojnë me lëndë djegëse dhe të gazta; Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të përdorshme në atmosfera potencialisht shpërthyes; Ashensorët;

	<p>Paketimi i mbetjeve; Instalime kabllore për transport personash; Eficienca energjetike e pajisjeve frigoriferike, ndriçimit fluoreshent dhe paketimi i pajisjeve elektroshtëpiake; -Direktivat e përafrimit të vjetër; Qelqi; Tekstilet Druri -Mbrojtja e konsumatorit dhe mbikëqyrja e tregut; -Liria e vendosjes dhe për të ofruar shërbime; -Legjislacioni për shoqëritë tregtare; -Zhvillimi rajonal; -Energjia; Sektori i energjisë; Sektori i hidrokarbureve; -Politikat industriale; Politikat industriale; Sektori i minierave; -SME-të, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme; -Kimikatet METE (është përgjegjëse për kimikatet si lëndë e parë për industrinë duke përfshirë import-eksportin).</p>
Ministria e Financave	<p>-Doganat; -Tatimet; -Menaxhimi i financave publike; -Parandalimi i pastrimit të parave;</p>
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	<p>- Legjislacioni horizontal për mjedisin; -Cilësia e ajrit; -Menaxhimi i mbetjeve; -Administrimi i burimeve ujore; -Parandalimi i ndotjes së ujit; -Mbrojtja e natyrës; -Ndotja dhe rreziqet industriale; -Kimikatet-MMPAU (është përgjegjëse për kimikatet si mbetje industriale të rrezikshme); -Organizmat e modifikuar gjenetikisht; -Zhurmat; -Ndryshimet klimatike; -Pyjet dhe kullotat; -Peshkimi; -Dialogu social.</p>
Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	<p>-Punësimi; -Mbrojtja shoqërore; -Shëndeti dhe siguria në punë; -Barazia gjinore; -Politika e migracioni; -Minoritetet; -Kimikatet-MPÇSSHB (në këtë institucion operon Inspektorati i Punës për Mbrojtjen e Punonjësve në Industri nga Kimikatet).</p>
Ministria e Shëndetësisë	<p>-Shëndeti publik; Sëmundjet ngjitëse; Mbrojtja nga duhani; Mbrojtja nga alkooli; Transfuzioni i gjakut; -Barnat për përdorim njerëzor; -Pajisjet mjekësore;</p>

	<ul style="list-style-type: none"> -Produktet kozmetike; -Siguria bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimet; -Njohja reciproke e kualifikimeve për profesionet e lira; -Kimikatet-MSH (është përgjegjëse për kimikatet spitalore dhe barnat).
Ministria e Brendshme	<ul style="list-style-type: none"> -Administrata publike; -Reforma e decentralizimit; -Gjendja civile; -Menaxhimi i kufijve; -Azili; -Krimi i organizuar dhe trafiket e paligjshme; -Lufta kundër drogës; Parandalimi i pastrimit të parave; -Lufta kundër terrorizmit; -Policia.
Ministria e Mbrojtjes	<ul style="list-style-type: none"> -Lufta kundër terrorizmit; Çminimi; -Materialet dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë.
Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	<ul style="list-style-type: none"> -Transporti rrugor; -Transporti hekurudhor; -Sistemi hekurudhor i shpejtësisë së lartë; -Mjetet motorike; -Transporti detar; -Transporti ajror; -Infrastrukturë rrugore; -Siguria rrugore; -Materialet e ndërtimit; -Menaxhimi i ujit të pijshëm; -Telekomunikacioni; -Shërbimet postare; -Kimikatet-MPPTT (është përgjegjëse për kimikatet nga mbetjet urbane).
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	<ul style="list-style-type: none"> -Arsimi dhe formimi profesional; -Mosdiskrimini në arsim; -Arsimi parauniversitar; -Arsimi i lartë; -Kërkimi shkencor; -Njohja e diplomave.
Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	<ul style="list-style-type: none"> -Lëvizja e lirë e mallrave kulturore; -Kultura dhe turizmi; -Të drejtat e pronësisë intelektuale.

ANEKSI II

KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E NËPUNËSVE TË NJËSIVE TË INTEGRIMIT EUROPIAN

Nëpunësi i njësisë së integrimit europian duhet të përzgjidhet në bazë të kriterëve të përgjithshme të mëposhtme:

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë;
- Grada master përbën avantazh;
- Eksperienca në punë të ngjashme përbën avantazh;
- Të ketë aftësi në përgatitje raportesh, analizash, komunikim dhe prezantim;
- Të ketë njohuri shumë të mira në gjuhën angleze;
- Njohja e një gjuhe të dytë të BE-së përbën avantazh;
- Të përdorë programet bazë të punës në kompjuter;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

VENDIM
Nr.18, datë 7.1.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË, TË SEKTORËVE, QË DO TË MBËSHETETEN,
DHE TË MASAVE TË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE
ZHVILLIMIN RURAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2009, për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, zëri “Transferte në buxhetet familjare”, të përdoren për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe të agropërpunimit.

2. Kriteret bazë për përdorimin e fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural të jenë:

- a) Efiçenca ekonomike;
- b) Efektiviteti;
- c) Nxitja e punës në grup e përfituesve;
- ç) Bashkëfinancimi nga përfituesit;
- d) Nxitja e investimeve në blloqe nga shumë përfitues;
- dh) Masa e kontrollit për procesin e zbatimit të programit;
- e) Aksesimi në treg i përfituesve nga programi;
- ë) Orientimi i masave, sipas rajonizimeve bujqësore.

3. Sektorët që mbështeten nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të jenë:

- a) Prodhimi i frutave, ullinjve dhe rrushit;
- b) Prodhimi i perimeve;
- c) Prodhimi i qumështit dhe i mishit;
- ç) Përpunimi i frutave dhe i rrushit;
- d) Përpunimi i perimeve;
- dh) Prodhimi i mjaltit;
- e) Ruajtja dhe tregtimi i frutave dhe i perimeve;
- ë) Prodhimi i produkteve organike;
- f) Infrastruktura fizike e fermës.

4. Masat e përfitimit të drejtpërdrejtë nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural të jenë për:

a) mbjelljen e pemëve frutore, (mollë, dardhë, kumbull, qersh, pjeshkë, lajthi, luleshtrydhe) ullinjve dhe agrumeve në bllok, jo më pak se 4 dynym për fermerë individualë dhe jo më pak se 1 ha për grup fermerësh, 50% e vlerës së projektit, por jo më shumë se 400 000 (katërqind mijë) lekë/ha;

b) mbjelljen e vreshtave në bllok, jo më pak se 5 dynym për fermerë individualë dhe jo më pak se 1 ha për grup fermerësh, 50% e vlerës së projektit, por jo më shumë se 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë/ha;

c) ujtjen me pika në pemëtore, agrumishte dhe ullishte intensive, 50% e vlerës së projektit, por jo më shumë se 300 000 (treqind mijë) lekë/ha;

ç) mbrojtjen e ullishtave nga miza e ullirit, 20 000 (njëzet mijë) lekë/ha.

d) certifikimin e produkteve bujqësore bio nga bimët e kultivuara, përkatësisht:

i) për prodhimet e destinuar për tregun e brendshëm, jo më shumë se 50% e kostos, por asnjëherë më shumë se 20 000 (njëzet mijë) lekë/fermë;

ii) për prodhimet për eksport, 50% e kostos së certifikimit, por jo më shumë se 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë/fermë/vit;

dh) prodhimin e fidanëve për llojet autoktone të rrushit: “Kallmet”, “Debinë” dhe “Vlosh”, “Pulës”, për fidanishte, për sipërfaqe jo më pak se 3 dynym, 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekë/ha;

e) ndërtimin e puseve për vaditje në pemëtore, agrumishte dhe ullishte, 50% e vlerës së projektit, por jo më shumë se 100 000 (njëqind mijë) lekë për pus;

ë) blerjen e plastmasit për serra të reja diellore, me madhësi 2 dynym e lart, 300 000 (treqind mijë) lekë/ha serrë;

f) serrat me ngrohje teknike, për prodhimin e perimeve, për ndryshimin e sistemit të përdorimit të lëndës djegëse nga naftë në solar, 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë/ha;

g) për prodhimin e kërpudhave, 50 për qind e vlerës së pajisjeve dhe instalimeve, por jo më shumë se 500 (pesëqind) mijë lekë për fermë;

gj) pagesën, me 10 000 (dhjetë mijë) lekë për kokë, për feramat blegtorale, që mbarështojnë mbi 10 krerë lopë qumështi, por jo më shumë se për 30 krerë. Përfitojnë vetëm fermerët, që e dokumentojnë me faturë shitjen e qumështit;

h) pagesën 500 (pesëqind) lekë për kokë dele, për tufat mbi 50 krerë dele, të matrikulluara. Përfitojnë vetëm fermerët, që dokumentojnë me faturë shitjen e qumështit.

i) pagesën për koshere blete, 500 (pesëqind) lekë për koshere, për fermerë me mbi 50 koshere;

j) mbarështimin intensiv të kërmillit, 50 për qind të vlerës së rasatit për ha, por jo më shumë se 500 (pesëqind) mijë për ha;

k) prodhimin e vajit të ullirit extravergine, 100 (një qind) lekë/litër;

l) mbështetjen, përmes subvencionimit, të normës së interesit për kreditë, që do të merren për veprimtaritë bujqësore ose agropërpunuese, si dhe për kreditë e marra gjatë vitit 2008 nga shoqëri, që ruajnë dhe përpunojnë produkte bujqësore, e grupet apo shoqëritë e prodhimit dhe të tregtimit në bujqësi, të regjistruara në mbështetje të ligjit nr.8088, datë 21.3.1996 “Për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok”, deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë, por jo më shumë se 50% të interesit, por jo më shumë se 3 vjet radhazi.

5. Procedura dhe mënyra e administrimit të fondit të programit përcaktohen me udhëzime të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

6. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM Nr.20, datë 14.1.2009

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE TË GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË DHE TË GJYKATAVE TË APELIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, të Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihet administrata gjyqësore e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit.

2. Struktura dhe nivelet e pagave të punonjësve të administratës gjyqësore, në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit, në pozicionet “Specialist”, “Sekretar gjyqësor”, “Kryetar dege”, “Kryesekretar gjyqësor” dhe “Përgjegjës i shërbimeve mbështetëse në Gjykatën e Krimeve të Rënda”, të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Paga e grupit, (kolona 1), diplomë e shkollës së lartë, është 11 000 lekë në muaj.
4. Shtesa për vjetërsi në punë, (kolona 2), jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, por jo më shumë se për 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.
5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1 të këtij vendimi.
Kategorizimi për çdo pozicion pune përcaktohet në urdhrin e miratimit të strukturës dhe të organikës së çdo gjykate.
6. “Specialistët”, në institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, që punojnë në pozicione, që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së administratës gjyqësore dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, arsimin e lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë“, përfitojnë një shtesë, për kushte pune, prej 10 000 lekësh mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Miratimi i kësaj shtese bëhet rast pas rasti, nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, në përputhje me përshkrimin e pozicionit të punës.
7. Punonjësit e tjerë të administratës së gjykatave, që nuk përfshihen në lidhjen nr.1, do të trajtohen në pagë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”.
8. Efektet financiare për vitin 2009 të përballohen nga fondet e miratuara për pushtetin gjyqësor, në buxhetin e vitit 2009.
9. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për zbatimin e këtij vendimi.
10. Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS
GJYQËSORE NË GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË DHE NË GJYKATAT E APELIT

PAGA MUJORE				
Pozicioni	Kategoria	Paga individuale (Paga bazë)		Shtesa e pozicionit
		1	2	3
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Përgjegjës i Shërbimeve Mbështetëse në Gjykatën e Krimeve të Rënda	III-a	11 000	2%	68 500
Kryesekretar gjyqësor Kryetar dege	III-b	11 000	2%	51 500
Sekretar gjyqësor Specialist	IV-a	11 000	2%	39 000

Specialist	IV-b	11 000	2%	29 000
------------	------	--------	----	--------

VENDIM
Nr.21, datë 14.1.2009

**PËR MIRATIMIN E KUADRIT MAKROEKONOMIK DHE TË TREGUESVE FISKALË,
PËR PERIUdhËN 2010-2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuadrit makroekonomik dhe të treguesve fiskalë, për periudhën 2010-2012, sipas lidhjes nr.1 “Treguesit kryesorë makroekonomikë” dhe lidhjeve nr.2 e nr.2/1 “Treguesit fiskalë, sipas buxhetit të konsoliduar”, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TREGUESIT KRYESORË MAKROEKONOMIKË

Lidhja nr.1

Treguesit	Njësia	2005	2006	2007 Vlera	2008 Vlera	2009 Pare.	2010 Pare.	2011 Pare.	2012 Pare.
				(Çmimet)					
Inflacioni (mesatar)	%	2.4	2.4	2.9	3.5	2.7	3.0	3.0	3.0
Inflacioni (fund-viti)	%	2.0	2.6	3.1	2.5	2.8	3.0	3.1	3.1
Deflatori PBB	%	2.6	3.6	3.3	3.9	2.5	3.2	3.3	3.5
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lekë /usd	99.9	98.1	90.4	83.2	92.9	93.0	93.5	94.1
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lekë euro	124.3	123.0	123.9	122.8	123.5	123.3	123.4	123.2
		(Treguesit e sektorit real)							
Rritja reale e PBB	%	5.8	5.5	6.0	7.2	6.0	6.7	6.9	6.6
Ritja sipas PBB tremujore/1				9.9					
PBB	Lekë miliardë	815.0	891.0	976.0	1086.0	1180.0	1299.0	1434.0	1583.0
Norma e papunësisë	%	14.1	13.8	13.2	12.5	12.3	11.8	10.2	9.7
		(Bilanci/ Kursime - Investime)							
Kursime të brendshme	%PBB	28.0	28.6	25.9	26.9	26.2	26.9	27.4	27.7
Publike	%PBB	1.4	2.8	3.3	4.7	4.9	5.5	5.8	5.9
Private	%PBB	26.6	25.8	22.6	22.2	21.3	21.4	21.6	21.8
Kursimet e huaja	%PBB	9.0	6.5	10.6	11.6	10.5	9.2	8.0	6.9
Investimet	%PBB	37.0	35.1	36.4	38.5	36.7	36.1	35.4	34.5
Publike	%PBB	5.6	6.7	6.5	9.3	8.8	8.3	8.0	7.9
<i>Nga të cilat: Qeveria qendrore</i>		4.7	5.7	5.8	8.4	7.7	7.3	7.0	6.8
Private	%PBB	31.4	28.4	29.9	29.2	27.9	27.8	27.4	26.7
		(Treguesit e sektorit Fiskal)							
Të ardhurat totale	Lekë miliardë	204.2	229.4	251.6	298.2	334.8	371.0	411.8	456.3
Shpenzimet totale	Lekë miliardë	232.3	258.8	285.7	355.0	384.8	414.4	455.5	501.5
<i>nga të cilat: interesa</i>	Lekë miliardë	26.0	25.0	25.6	31.6	36.0	37.2	40.3	42.0
Bilanci i përgjithshëm	Lekë miliardë	-28.2	-29.4	-34.1	-56.8	-50.0	-43.4	-43.7	-45.2
Bilanci primer	Lekë miliardë	-2.1	-4.4	-8.5	-25.2	-14.0	-6.2	-3.4	-3.2
Huamarrja e brendshme neto	Lekë miliardë	20.6	20.7	17.0	20.1	41.5	29.7	30.6	31.5
Të ardhura nga privatizimet	Lekë miliardë	0.9	2.0	13.2	2.0	0.2	0.3	0.3	0.3
Huamarrja e huaj neto	Lekë miliardë	5.9	5.3	5.0	34.7	8.3	8.8	8.8	9.7
Borxhi publik total	Lekë miliardë	467.8	494.0	516.5	571.2	621.0	659.6	698.9	740.1
I brendshëm	Lekë miliardë	327.4	348.9	369.5	389.6	431.1	460.8	491.4	522.9
I huaj	Lekë miliardë	140.4	145.0	146.9	181.6	189.9	198.7	207.5	217.1
Të ardhurat totale	%PBB	25.1	25.8	25.8	27.4	28.4	28.6	28.7	28.8
Shpenzimet totale	%PBB	28.5	29.0	29.3	32.7	32.6	31.9	31.8	31.7
<i>nga të cilat: interesa</i>	%PBB	3.2	2.8	2.6	2.9	3.1	2.9	2.8	2.7
Bilanci i përgjithshëm	%PBB	-3.5	-3.3	-3.5	-5.2	-4.2	-3.3	-3.0	-2.9
Bilanci primar	%PBB	-0.3	-0.5	-0.9	-2.3	-1.2	-0.5	-0.2	-0.2
Huamarrja e brendshme neto	%PBB	2.5	2.3	1.7	1.8	3.5	2.3	2.1	2.0
Të ardhura nga privatizimet	%PBB	0.1	0.2	1.4	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0
Huamarrja e huaje neto	%PBB	0.7	0.6	0.5	3.2	0.7	0.7	0.6	0.6
Borxhi publik total	%PBB	57.4	55.4	52.9	52.6	52.6	50.8	48.7	46.8
I brendshëm	%PBB	40.2	39.2	37.9	35.9	36.5	35.5	34.3	33.0
I huaj	%PBB	17.2	16.3	15.1	16.7	16.1	15.3	14.5	13.7
		(Treguesit e sektorit të huaj)							
Bilanci tregtar (mallra & shërbime)	%PBB	-24.7	-23.3	-26.6	-26.0	-24.1	-22.0	-20.1	-18.2
Mallra	%PBB	-22.5	-22.9	-26.7	-27.2	-26.4	-25.5	-24.7	-24.0
Bilanci i llogarisë korrente	%PBB	-9.0	-6.5	-10.6	-11.6	-10.5	-9.2	-8.0	-6.9
Bilanci i pagesave	%PBB	1.9	2.9	1.9	1.5	-0.4	0.6	1.6	2.3
Bilanci i pagesave	USD milionë	155.4	259.0	203.6	200.2	-55.8	90.6	241.0	379.6
Rezervat valutore	USD milionë	1325.5	1700.0	2033.9	2228.8	1941.2	2030.0	2260.1	2625.3
Në muaj importi mall e shërbime	Muaj	4.2	4.5	3.8	3.7	3.5	3.4	3.4	3.6
Në % të parasë së gjerë	%	23.7	23.6	22.2	22.0	19.6	18.3	18.2	19.1

Burimi: INSTAT-i, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave

1. Vlerësimi i Ministrisë së Financave

2. Rritja për periudhën tetor 2007-shtator 2008, sipas produktit të brendshëm bruto tremujor-INSTAT

TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR

Në % të PBB

Nr.	EMËRTIMI	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
					A.Normativ	Buxheti	PBA	PBA	PBA
	TOTALI I TE ARDHURAVE	204,163	229,444	251,555	298,220	334,823	371,009	411,846	456,335
1.	Të ardhura nga ndihmat	6,168	8,025	1,280	2,507	6,313	6,490	7,145	8,074

II.	Të ardhura tatimore	183,816	205,523	228,164	270,952	305,988	340,646	379,396	421,437
II.1	Nga tatimet dhe doganat	135,606	155,102	176,808	209,711	230,168	254,714	282,978	313,546
1	Tatimi mbi vlerën e shtuar	64,534	74,268	87,771	106,903	117,491	130,415	145,032	160,835
2	Tatimi mbi fitimin	19,237	22,258	21,077	18,420	20,813	23,331	25,946	28,773
3	Akcizat	18,523	22,997	28,731	35,493	44,363	49,730	55,852	62,551
4	Tatimi mbi të ardhurat personale	7,402	8,580	14,850	23,272	26,065	28,646	31,541	34,631
5	Taksa nacionale dhe të tjera	12,281	13,008	14,531	16,212	15,312	16,991	18,527	20,145
6	Taksa doganore	13,629	13,991	9,848	9,411	6,124	5,600	6,080	6,611
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	12,019	11,112	9,366	13,082	18,412	20,947	23,434	26,153
III.3	Të ardh buxh.pavarur (kontribute)	36,192	39,909	41,989	48,159	57,408	64,985	72,984	81,737
III.	Të ardhura jotatimore	14,178	15,895	22,112	24,761	22,522	23,873	25,305	26,824
	TOTALI I SHPENZIMEVE	232,339	258,816	285,674	354,760	384,834	414,434	455,521	501,538
1.	Shpenzime korrente	193,964	204,860	224,976	254,841	286,798	305,571	338,039	372,631
1.1	Personeli	53,674	56,709	59,087	67,060	62,751	67,771	75,226	83,125
1.2	Interesat	26,029	25,006	25,595	31,575	36,040	37,240	40,316	42,003
1	Të brendshme	24,184	22,978	23,499	28,400	31,420	32,000	34,000	35,000
2	Të huaja	1,845	2,028	2,096	3,175	4,620	5,240	6,316	7,003
1.3	Shpenzime operative. Mirëmbajtje	24,515	22,794	25,259	28,079	35,813	40,469	47,348	55,398
1.4	Subvencionet	3,653	3,835	3,536	2,566	2,022	2,500	2,900	2,900
1.5	Mbështetje për energjinë	0	0	5,000	0	0			
1.6	Shpenzime për sig.sociale dhe transferime të tjera	55,876	60,029	69,892	77,873	95,866	100,417	107,195	115,770
1.7	Buxheti lokal	19,999	22,713	21,340	29,146	36,835	39,432	42,634	47,732
1.8	Shpenzime të tjera	10,218	13,775	15,268	18,042	16,871	19,042	21, 220	24,003
II.	Fondi rezervë	0	0	0	5,700	12,600	12,652	17,373	20,872
III.	Shpenzime kapitale	38,375	51,108	57,040	91,139	90,436	94,211	100,109	108,035
IV.	Transferta të ndryshme	0	2,848	3,658	2,600	-5,000	0	0	0
	DEFICITI	-28,176	-29,372	-34,119	-56,540	-50,011	-43,425	-43,675	-45,203
	FINANCIM I DEFICITIT	28,176	29,372	34,119	56,541	50,011	43,425	43,675	45,203
	Brendshëm	23,299	23,623	28,829	21,847	41,699	34,625	34,925	35,543
	Te ardhura nga privatizimi	887	1,972	13,246	2,000	200	300	300	300
	Huamarrje e brendshme	20,617	20,742	17,039	19,847	41,499	29,718	30,600	31,514
	Të tjera	1,795	909	-1,456	0				
	I huaj	4,878	5,749	5,290	34,694	8,312	8,800	8,750	9,660
	Hua afatgjatë (e marrë)	9,221	9,936	9,109	39,644	15,462	17,000	18,000	19,000
	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-979	403	279					
	Ripagesat	-3,364	-4,590	-4,098	-4,950	-7,150	-8,200	-9,250	-9,340

TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR

Në % të PBB

Nr.	EMËRTIMI	2005	2006	2007	2008	2008	2009	2010	2011	2012
					A. Normativ	A. Normativ (i rishikuar për efekt të rritjes ekonomike)	buxheti	PBA	PBA	PBA
	TOTALI I TE ARDHURAVE	25.1	25.8	25.8	27.7	27.5	28.4	28.6	28.7	28.8
I.	Të ardhura nga ndihmat	0.8	0.9	0.1	0.2	0.2	0.5	0.5	0.5	0.5
II.	Të ardhura tatimore	22.6	23.1	23.4	25.1	24.9	25.9	26.2	26.5	26.6
II.1	Nga tatimet dhe doganat	16.6	17.4	18.1	19.5	19.3	19.5	19.6	19.7	19.8
1	Tatimi mbi vlerën e shtuar	7.9	8.3	9.0	9.9	9.8	10.0	10.0	10.1	10.2
2	Tatimi mbi fitimin	2.4	2.5	2.2	1.7	1.7	1.8	1.8	1.8	1.8
3	Akçizat	2.3	2.6	2.9	3.3	3.3	3.8	3.8	3.9	4.0
4	Tatimi mbi të ardhurat personale	0.9	1.0	1.5	2.2	2.1	2.2	2.2	2.2	2.2
5	Taksa nacionale dhe të tjera	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.3	1.3	1.3	1.3
6	Taksa doganore	1.7	1.6	1.0	0.9	0.9	0.5	0.4	0.4	0.4
II.2	Të ardhura nga Pushteti Lokal	1.5	1.2	1.0	1.2	1.2	1.6	1.6	1.6	1.7
II.3	Të ardhurat e buxhetit të pavarur (kontribute)	4.4	4.5	4.3	4.5	4.4	4.9	5.0	5.1	5.2
III.	Të ardhura Jotatimore	1.7	1.8	2.3	2.3	2.3	1.9	1.8	1.8	1.7
	TOTALI I SHPENZIMEVE	28.5	29.0	29.3	32.9	32.7	32.6	31.9	31.8	31.7
I.	Shpenzime korrente	23.8	23.0	23.1	23.6	23.5	24.3	23.5	23.6	23.6
I.1	Personeli	6.6	6.4	6.1	6.2	6.2	5.3	5.2	5.2	5.3
I.2	Interesat	3.2	2.8	2.6	2.9	2.9	3.1	2.9	2.8	2.7
1	Të brendshme	3.0	2.6	2.4	2.6	2.6	2.7	2.5	2.4	2.2
2	Të huaja	0.2	0.2	0.2	0.3	0.3	0.4	0.4	0.4	0.4
I.3	Shpenzime operative mirëmbajtje	3.0	2.6	2.6	2.6	2.6	3.0	3.1	3.3	3.5
I.4	Subvencionet	0.4	0.4	0.4	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
I.5	Mbështetje për energjinë	0.0	0.0	0.5						0 0
I.6	Shpenzime për sig. sociale dhe transferime të tjera	6.9	6.7	7.2	7.2	7.2	8.1	7.7	7.5	7.3
I.7	Buxheti lokal	2.5	2.5	2.2	2.7	2.7	3.1	3.0	3.0	3.0
I.8	Shpenzime të tjera	1.3	1.5	1.6	1.7	1.7	1.4	1.5	1.5	1.5
II.	Fondi rezerve	0.0	0.0	0.0	0.5	0.5	1.1	1.0	1.2	1.3
III.	Shpenzime kapitale	4.7	5.7	5.8	8.5	8.4	7.7	7.2	7.0	6.8
IV.	Transferta të ndryshme	0.0	0.3	0.4	0.2	0.2	-0.4	0.0	0.0	0.0
	DEFICITI	-3.5	-3.3	-3.5	-5.2	-5.2	-4.2	-3.3	-3.0	-2.9
	FINANCIMI I DEFICITIT	3.5	3.3	3.5	5.2	5.2	4.2	3.3	3.0	2.9
	Brendshëm	2.9	2.7	3.0	2.0	2.0	3.5	2.7	2.4	2.2
	Të ardhura nga privatizimi	0.1	0.2	1.4	0.2	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0
	Huamarrje e brendshme	2.5	2.3	1.7	1.8	1.8	3.5	2.3	2.1	2.0
	Të tjera	0.2	0.1	-0.1						
	I huaj	0.6	0.6	0.5	3.2	3.2	0.7	0.7	0.6	0.6
	Hua afatgjatë (e marrë)	1.1	1.1	0.9	3.7	3.7	1.3	1.3	1.3	1.2
	Ndryshimi i gjendjes së arkës	-0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0			
	Ripagesat	-0.4	-0.5	-0.4	-0.5	-0.5	-0.6	-0.6	-0.6	-0.6

VENDIM
Nr.52, datë 14.1.2009

**PËR CILËSINË E LËNDËS DJEGËSE GAZOIL (DIEZEL), TË PRODHUAR NGA
RAFINIMI I NAFTËS BRUTO, TË NXJERRË NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, DHE TË TREGTUAR PËR AUTOMJETE RRUGORE E GJENERATORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 10 të ligjit nr.8897, datë 16.5.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, dhe të neneve 8 e 9 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e përdorimit në territorin e Republikës së Shqipërisë deri më 31 dhjetor 2009 të lëndës djegëse gazoil (diezel), për automjetet rrugore dhe gjeneratorë, e cila në nomenklaturën e mallrave, përshkruhet në kodin 27101945 dhe plotëson kërkesat e standardit S SH 31:1997 ose të standardeve të tjera, të barazvlefshme me të, vetëm për lëndën, që prodhohet në rafineritë e vendit nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë nga vendburimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Lejimin e ARMO, sha-së, t’ua shesë produktin e vet gazoil (diezel), që në nomenklaturën e mallrave përshkruhet në kodin 27101945 dhe që plotëson kërkesat e standardit S SH 31:1997 ose të standardeve të tjera, të barazvlefshme me të, vetëm subjekteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, të pajisura me “leje tregtimi të llojit A”, sipas legjislacionit në fuqi.

3. ARMO, sha-ja, për shkak të pozicionit dominues në treg për produktin gazoil (diezel), që, në nomenklaturën e mallrave, përshkruhet në kodin 27101945 dhe që plotëson kërkesat e standardit S SH 31:1997 ose të standardeve të tjera, të barazvlefshme me të, duhet t’u ofrojë, të gjitha subjekteve tregtare të licencuara, çmime dhe kushte të njëjta e transparente tregtimi.

4. Çmimet e shitjes, të negociuara nga ARMO, sha-ja, dhe subjektet tregtare, të licencuara për produktin gazoil (diezel), që, në nomenklaturën e mallrave, përshkruhet në kodin 27101945 dhe që plotëson kërkesat e standardit S SH 31:1997 ose të standardeve të tjera, të barazvlefshme me të, duhet:

- a) të jenë të orientuara drejt kostos së këtij produkti;
- b) të reflektojnë luhatjet e çmimit për këtë produkt në tregun evropian të bursës PLATTS dhe në tregun rajonal;
- c) të respektojnë raportin e ndryshimit të çmimit, ndërmjet produktit gazoil (diezel), që, në nomenklaturën e mallrave, përshkruhet në kodin 27101945 e që plotëson kërkesat e standardit S SH 31:1997, dhe të produktit gazoil (diezel), që, në nomenklaturën e mallrave, përshkruhet në kodin 27101941 e që plotëson kërkesat e standardit S SG EN 590 ose të standardeve të tjera, të barazvlefshme me të.

5. ARMO, sha-ja brenda datës 5 (pesë) të çdo muaji duhet të raportojë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Autoritetit të Konkurrencës për:

- i) sasinë e naftës bruto të blerë;
- ii) sasinë e prodhimit të realizuar nga rafinimi;
- iii) sasinë e tregtuar të produkteve të rafinimit;
- iv) çmimet e blerjes dhe të shitjes, sipas kontratave të shitblerjes për këto produkte;
- v) kushtet e tjera të tregtimit, gjatë muajit parardhës.

6. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, lënda djegëse (diezel), që, në nomenklaturën e mallrave, përshkruhet në kodin 27101941, dhe që plotëson kërkesat e standardit shqiptar S SH EN 590 ose të standardeve të tjera, të barazvlefshme me të, dhe është prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë nga vendburimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, lejohet të tregtohet për automjetet rrugore dhe për gjeneratorë vetëm sipas kushteve të mëposhtme:

- a) Nga data 1 janar 2010, përmbajtja e squfurit në lëndën djegëse, për motorët diezel nuk lejohet të kalojë vlerën 350 mg/kg dhe përmbajtja e hidrokarbureve policiklike aromatike nuk lejohet të kalojë vlerën 16 % m/m.

b) Nga data 1 janar 2011, përmbajtja e squfurit nuk lejohet të kalojë vlerën 150 mg/kg dhe përmbajtja e hidrokarbureve policiklike aromatike nuk lejohet të kalojë vlerën 16 % m/m.

c) Nga data 1 janar 2012, përmbajtja e squfurit nuk lejohet të kalojë vlerën 10 mg/kg dhe lënda djegëse gazoil (diezel) duhet të plotësojë kërkesat e standardit shqiptar që, në nomenklaturën e mallrave, përshkruhet me kodin 27101941, e që plotëson kërkesat e standardit S SH EN 590 ose të standardeve të tjera, të barazvlefshme me të.

7. Nëse pas afateve të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” e “c”, të pikës 6, të këtij vendimi, vërehet tregtimi i lëndës djegëse (diezel) me cilësi, që nuk respekton kërkesat e këtij vendimi, ajo sekuestrohet dhe dërgohet në destinacionin e përcaktuar nga Inspektorati Qendror Teknik.

8. Subjektet importuese të lëndës djegëse gazoil (diezel), që në nomenklaturën e mallrave përshkruhet në kodin 27101945 dhe që plotëson kërkesat e standardit S SH 31:1997 ose të standardeve të tjera, të barazvlefshme me të, lejohen të importojnë vetëm kur paraqesin në organin doganor dhe në Inspektoratin Qendror Teknik, kontratën e shitjes, me përdoruesit, ku është specifikuar destinacioni i përdorimit në Shqipëri, për sasinë e produktit që importojnë, destinacion, i cili duhet të jetë i ndryshëm nga tregtimi për përdorim në automjete rrugore dhe gjeneratorë. Organi tatimor, në mënyrë periodike, bën verifikimin e përdorimit, sipas kontratave dhe destinacionit dhe informon Inspektoratin Qendror Teknik.

9. Sasitë e lëndës djegëse gazoil (diezel), që në nomenklaturën e mallrave përshkruhet në kodin 27101945 dhe që plotëson kërkesat e standardit S SH 31:1997, të cilat janë importuar para datës 1 janar 2009 dhe janë gjendje në magazinat doganore apo pikat e depozitimit dhe tregtimit, lejohen të tregtohen.

10. Vendimi nr.1110, datë 30.7.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për cilësinë e lëndës djegëse diezel, të prodhuar nga ratifikimi i naftës bruto vendase”, shfuqizohet.

11. Ngarkohet ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe ministri i Financave për nxjerrjen e një udhëzimi të përbashkët në dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM **Nr.9, datë 29.1.2009**

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.52, DATË 14.1.2009 “PËR CILËSINË E LËNDËS DJEGËSE GAZOIL (DIEZEL) TË RAFINUAR NGA PRODHIMI I NAFTËS BRUTO TË NXJERRË NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE TREGTUAR PËR AUTOMJETE RRUGORE DHE GJENERATORË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 10 të ligjit nr.8897, datë 16.5.2002 “Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja” dhe neneve 8 dhe 9 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.1.2009 “Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil (diezel) të rafinuar nga prodhimi i naftës bruto të nxjerrë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe tregtuar për automjete rrugore dhe gjeneratorë”, Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

UDHËZOJNË:

1. Në zbatim të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.1.2009, subjektet importuese të lëndës djegëse gazoil (diezel), që në nomenklaturën e mallrave përshkruhet në kodin 27101945 dhe që plotëson kërkesat e standardit SSh 31:1997 ose të standardeve të tjera, të barazvlefshme me të, do të lejohen të importojnë vetëm kur paraqesin në organin doganor dhe në

Inspektoratin Qendror Teknik, kontratën e shitjes, me përdoruesit, ku është specifikuar destinacioni i përdorimit në Shqipëri, për sasinë e produktit që importojnë, destinacion, i cili duhet të jetë i ndryshëm nga tregtimi për përdorim në automjete rrugore dhe gjeneratorë. Organi tatimor, në mënyrë periodike, bën verifikimin e përdorimit, sipas kontratave dhe destinacionit, dhe informon Inspektoratin Qendror Teknik.

2. Organi doganor do të kryejë procedurat për hedhjen në qarkullim të lirë të lëndës djegëse gazoil (diezel) që në nomenklaturën e mallrave përshkruhet në kodin 27101945 dhe që plotëson kërkesat e standartit SSH 31:1997 ose të standarteve të tjera të barazvlefshme me të, pasi të jetë marrë konfirmimi zyrtar nga Inspektoriati Qendror Teknik, (IQT) për lejimin e importit, vetëm për ato subjekte, të cilat përmbushin kriteret e përcaktuar në këtë udhëzim, sa më poshtë:

a) Depozitohen pranë Inspektoriatit Qendror Teknik (IQT) kontrata të shitjes me përdoruesit, me destinacion të ndryshëm nga përdorimi për automjete rrugore dhe gjeneratorë;

b) E gjithë sasia e importuar, denatyrohet dhe ngjyroset sipas standartit të BE-së (Solven Yelloe 124, me ëmer shkencor N- etil-N – [2-[1-(2-isobutossierossi) etil] -4 – (fenilazo) aniline). Niveli i ngjyritimit duhet të jetë jo më pak se 6 mg/l gazoil dhe jo më shumë se 9 mg/l. Ngjyrosja është detyrim i subjektit importues dhe mund të kryhet si pranë prodhuesit ashtu edhe në kalatën e portit apo vendndodhje tjetër, konform procedurave doganore në fuqi, në prezencën e inspektorit/eve të IQT dhe të doganierit/eve (përveçse kur ngjyrosja kryhet në ambjentet e prodhuesit). Inspektorët e IQT, konform ligjit, kryejnë procedurat e marrjes së mostrave dhe analizës së mallit.

3. Inspektorati Qendror Teknik në zbatim të kushteve të mësipërme, lëshon një vërtetim konfirmimi për subjektin importues, një kopje e të cilit, së bashku me kopje të kontratës, i përcillet Degës Doganore përkatëse. Gjithashtu, kopje e kontratës i përcillet edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Afati i kryerjes së procedurave (nga momenti i dorëzimit të kontratave dhe ngjyrosjes së gazoilit në marrjen e vërtetimit të konfirmimit nga IQT) nuk duhet të jetë më shumë se 3 ditë.

4. Me marrjen e këtij vërtetimi nga IQT, Organi i Degës Doganore përkatëse lejon importimin dhe realizon hedhjen në qarkullim të lirë të sasisë së importuar.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet strukturave kontrolluese bën kontrolle për efekt të zbatimit të kontratave të depozitura nga Subjektet Importuese. Për rastet kur ajo konstaton shkelje të kontratave informon IQT.

6. Inspektorati Qendror Teknik monitoron përdorimin në Shqipëri të sasive të importuara të kësaj lënde djegëse gazoil (diezel).

Në rast, të verifikimit të ndryshimit të destinacionit të përdorimit nga kontrata e shitjes dhe identifikimit të ndryshimit të destinacionit në tregtim, IQT aplikon masa penalizuese, sekuestron sasinë e importuar, dhe/ose i propozon Ministrit të Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës heqjen e lejeve të tregtimit.

7. Sasitë e lëndës djegëse gazoil (diezel), që në nomenklaturën e mallrave përshkruhet në kodin 27101945 dhe që plotëson kërkesat e standardit SSH 31:1997, të cilat janë importuar para datës 1 janar 2009 dhe janë gjendje në magazinat doganore apo pikat e depozitimit dhe tregtimit, lejohen të tregtohen pa iu nënshtruar kushteve të pikës 1 të këtij udhëzimi, si dhe pa u ngjyrosur.

8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode

MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERJITIKËS

Genc Ruli

ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”,
prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 29.1.2009
Doli nga shtypi më 29.1.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 22 lekë